

Standardet Kombëtare të Kontabilitetit të Përmirësuara**SKK 4 INVENTARËT**

Pg.	
	STANDARDI KOMBËTAR I KONTABILITETIT NR. 4 – INVENTARËT – I PËRMIRËSUAR
	PËRMBAJTJA <i>Paragrafët</i>
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES 1-3
	FUSHA E ZBATIMIT 4-5
	PËRKUFIZIMET KRYESORE 6-7
	NJOHJA DHE VLERËSIMI 8- 29
	Njohja në kontabilitet 8 - 9
	Matja fillestare 10-12
	Vlerësimi i mëpasshëm 13 -22
	Zhvlerësimi i inventarit 23- 28
	Çregjistrim 29 – 30
	PARAQITJA E INVENTARIT NË PASQYRAT FINANCIARE 31 - 33
	SHËNIMET SHPJEGUESE 34
	DATA E HYRJES NË ZBATIM 35
	KRAHASIMI ME STANDARDET NDERKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITË EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PER NVM) 36
	BAZA E KONKLUZIONEVE
	UDHËZUES PËR ZBATIMIN E SKK 4
	OBJEKTIVI DHE BAZAT E PËRGATITJES
1	Objektivi i Standardit Kombëtar të Kontabilitetit 4 <i>Inventarët</i> (‘SKK 4’ ose ‘Standardi’) i nxjerrë dhe i miratuar nga Këshilli Kombëtar i Kontabilitetit dhe shpallur nga Ministria e Financës, është dhënia e parimeve të njohjes, matjes dhe vlerësimit të mëpasshëm të inventarëve si dhe të shpjegimeve të nevojshme në pasqyrat financiare të përgatitura në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit. Këto standarde bazohen në parimet e kontabilitetit dhe raportimit të pranuar në shkallë ndërkombëtare, kërkesat e përgjithshme të të cilëve përshkruhen në Ligjin nr. 9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, publikuar në prill 2004, i ndryshuar.
2	SKK 4 mbështetet në Standardin Ndërkombëtar të Kontabilitetit, SNK 2 <i>Inventarët</i> . SKK 4 është ndryshuar për t’u bërë i krahasueshëm me Seksionin 13 – <i>Inventarët</i> të Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar për Njësitet e Vogla dhe të Mesme (SNRF për NVM). Një tabelë korresponduese e paragrafeve të Standardit me paragrafe të SNRF për NVM është dhënë në paragrafin 36. Për rastet që nuk janë trajtuar në mënyrë të drejtpërdrejtë nga SKK 4 ose ndonjë SKK tjetër, drejtuesit e njësisë ekonomike duhet që, me miratimin e Këshillit Kombëtar të Kontabilitetit, të aplikojnë një politikë të atillë që siguron një pasqyrim të vërtetë dhe të besueshëm të pozicionit financiar, performancës financiare dhe ndryshimeve të fluksit të mjeteve monetare dhe të kapitalit të njësisë ekonomike siç kërkohet në nenin 9 të Ligjit nr. 9228 “Për Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare”, nxjerrë në prill 2004, i ndryshuar.
3	Pasqyrat financiare do të përgatiten mbi bazën e konceptit të materialitetit. Standardet Kombëtare të Kontabilitetit nuk duhet të zbatohen për zërat jomaterialë. Koncepti i materialitetit përkufizohet dhe sqarohet në paragrafët 40 deri 90 të SKK 1.
	FUSHA E ZBATIMIT
4	Ky Standard do të zbatohet për të gjithë inventarët me përjashtim të: (a) punës në proces në lidhje me kontratat e ndërtimit (shih SKK 8 <i>Të Ardhurat</i>) (b) instrumentet financiare (shih SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i>) (c) aktivet biologjike që lidhen me aktivitetin bujqësor dhe prodhimin bujqësor në momentin e vjeljes (shih SKK 13 <i>Aktivët Biologjike dhe Marrëveshjet Konçesionare</i>)
5	Ky Standard nuk aplikohet për inventarët e mbajtur nga: (a) prodhuesit e produkteve bujqësore dhe pyjore, prodhimin bujqësor pas vjeljes dhe të mineraleve dhe produkteve minerale, në rastet kur ato janë të matura me vlerën e drejtë pakësuar me kostot për shitje përmes fitimit apo humbjes (shih

	SKK 13 <i>Aktivet Biologjike dhe Marrëveshjet Konçesionare</i>), ose (b) brokerat dhe agjentët e shitjes së mallrave që i matin inventarët me vlerën e drejtë pakësuar me kostot e shitjes përmes fitimit ose humbjes (shih SKK 3 <i>Instrumentet Financiare</i>).
	PËRKUFIZIMET KRYESORE
6	Më poshtë jepen disa përkufizime kryesore të përdorur në këtë standard: <i>Inventarët</i> janë aktivet: (a) e mbajtura për shitje në rrjedhën normale të njësisë ekonomike (b) që ndodhen në procesin e prodhimit, ose (c) në formë materialesh ose furnizimesh për t'u përdorur në procesin e prodhimit ose në kryerjen e shërbimeve. <i>Vlera kontabël</i> është vlera me të cilën është njohur një aktiv në pasqyrën e pozicionit financiar.
7	Inventarët e njësisë prodhuese përbëhen nga lëndët e para dhe materialet për konsum, puna në proces dhe produktet e përfunduara gati për shitje, mallrat e blera dhe të mbajtura për rishitje me pak ose aspak nevojë për ndryshim, që janë inventarë tipike për njësitë tregtare. Pronat e paluajtshme të blera për rishitje duhet të njihen si inventar, ndërsa ato të blera për përdorim në procesin e prodhimit ose për qëllime administrative, duhet të njihen si aktive afatgjata materiale.
	NJOHJA DHE VLERËSIMI
	Njohja në kontabilitet
8	Fillimisht, njësia ekonomike duhet ta njohë inventarin atëhere kur e ka nën kontroll, pret përfitime ekonomike prej tij dhe kostoja e tij mund të vlerësohet me besueshmëri.
9	Njohja e inventarëve duhet të bëhet zakonisht në momentin e përfitimit.
	Matja fillestare
10	Inventarët maten fillimisht me kosto. Kostoja e inventarit përfshin: koston e të gjitha materialeve të lidhura drejtpërdrejt me prodhimin si dhe koston e shndërrimit të këtyre materialeve në produkte përfundimtare. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për të sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese.
11	Kostoja e lëndëve të para, materialeve të konsumit, tokës dhe ndërtesave të blera për rishitje, përbëhet nga çmimi i blerjes, shpenzimet e transportit, taksat e importit, magazinimi, zbritjet dhe shtesat tregtare dhe të tjera shpenzime të tjera të ngjashme (taksat e parimbursueshme).
12	Një njësi ekonomike mund t'i blejë inventarët në kushtet e shlyerjes së shtyrë. Në disa raste, marrëveshja përmban efektivisht një element financimi të pashpalluar, për shembull, një diferencë midis çmimit të blerjes në kushtet e kreditimit normal dhe shumës së shlyerjes së shtyrë. Në këto raste, diferenca njihet si shpenzim interesi gjatë periudhës së financimit dhe nuk i shtohet koston së inventarit.
	Vlerësimi i mëpasshëm
13	Pas njohjes, një njësi ekonomike duhet të matë inventarin me vlerën më të ulët midis koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.
14	Për ato mallra që nuk janë të këmbyeshme në tregje të zakonshme apo që janë të veçanta për projekte specifike, kostoja duhet të përcaktohet mbi bazën e metodës së identifikimit specifik. Metoda e koston bazuar në identifikimin specifik nuk është e përshtatshme për produkte homogjene si për shembull lëndët e para që përdoren në prodhim dhe pjesët e këmbimit që blihen shpesh dhe me çmime të ndryshme. Për të përcaktuar koston e një inventari të tillë, duhet të përdoret ose mesatarja e ponderuar ose metoda "hyrje e parë, dalje e parë" (FIFO). Për të llogaritur koston e inventareve që kanë të njëjtën natyrë dhe përdorim për njësinë ekonomike, duhet të përdoret e njëjta formulë. Megjithatë, për inventarët me natyrë ose përdorim të ndryshëm, për llogaritjen e koston mund të justifikohet përdorimi i formulave të ndryshme nga ato të përmendura më sipër.
15	Njësitë ekonomike që merren me prodhim produktesh duhet të përcaktojnë koston e inventarit të tyre. Kostoja e inventarit duhet të përfshijë të gjitha kostot e blerjes, kostot e shndërrimit/prodhimit dhe kostot që lidhen me sjelljen e inventarit në kushtet dhe vendndodhjen ekzistuese. Metoda të bazuara në koston direkte ku të gjitha shpenzimet indirekte futen në shpenzimet e periudhës nuk lejohen. Kostot indirekte duhet t'i ngarkohen inventarit pavarësisht se si klasifikohen ato nga njësia ekonomike.
16	Shembuj të shpenzimeve që nuk mund të përfshihen në koston e inventarit janë dhënë më poshtë: (a) shpenzimet e punëve kërkimore (b) shumat mbi normalen nga dëmtimet, firot, kostot e prodhimit dhe të punës, penaltete dhe të tjera të ngjashme; (c) shpenzimet e shitjes (d) shpenzimet e përgjithshme të administrimit që nuk kontribuojnë në sjelljen e inventarëve në vendndodhjen dhe kushtet aktuale.
17	Shpenzimet indirekte fikse të prodhimit llogariten si pjesë e koston së inventarit duke marrë për bazë kapacitetin normal të

	prodhimin. Kapaciteti normal është niveli i prodhimit që një njësi ekonomike pret të arrijë mesatarisht gjatë një sërë periudhash kontabël. Shpenzimet indirekte variabël të prodhimit llogariten duke marrë për bazë prodhimin aktual. Një njësi ekonomike duhet t'i ngarkojë shpenzimet indirekte të pashpërndara në shpenzimet e periudhës kontabël, si për shembull shpenzimet e pangarkuara për shkak të ndryshimit të shfrytëzimit aktual të kapacitetit nga kapaciteti i plotë.
18	Kapitalizimi i shpenzimeve të magazinimit, d.m.th. përfshirja e tyre në koston e inventarit, në vend që të ngarkohen në shpenzime, është i përshtatshëm vetëm nëse magazinimi është i domosdoshëm gjatë procesit të prodhimit d.m.th. magazinim i ndërmjetëm para se të kalohet në një fazë të mëtejshme prodhimi.
19	Produktet që prodhohen së bashku, d.m.th. në një proces të vetëm prodhimi, njihen si bashkëprodukte. Ato shpenzime prodhimi të cilat janë kryer duke filluar nga momenti kur këto produkte bëhen individualisht të identifikueshme mund të lidhen lehtësisht dhe drejtpërdrejtë me produktin dhe rrjedhimisht mund të shpërndahen nëpër produktet individuale në mënyrë të drejtpërdrejtë. Shpenzimet e prodhimit të cilat janë kryer para këtij momenti duhet të shpërndahen nëpër produktet individuale në bazë të një metode të arsyeshme dhe të përshtatshme.
20	Shpërndarja e shpenzimeve mbi bazën e vlerës relative të shitjeve të produkteve të përbashkëta është një nga metodat për shpërndarjen e shpenzimeve të përbashkëta. Shpenzimet e përbashkëta shpërndahen në bazë të vlerës relative të shitjes së produkteve, d.m.th. në përpjestim me vlerën e tyre të shitjes, në momentin kur këto produkte bëhen individualisht të identifikueshme, d.m.th. në pikën e ndarjes. Kjo metodë ka vlera praktike kur bashkëproduktet kanë fitime të njëjta, por nuk është e përshtatshme kur produktet kanë ndryshime të konsiderueshme në fitim, pasi shpërndarja nuk do t'i pasqyrojë në mënyrë të drejtë kostot që i takojnë çdo produkti.
21	Nënproduktet janë produkte të përbashkëta me një vlerë relativisht të parëndësishme, dhe vlerësimi i tyre në mënyrë të ngjashme me atë të produktit kryesor, nuk është i përshtatshëm. Një alternativë e përshtatshme është që shpenzimet e nënprodukteve në një shumë të barabartë me vlerën e tyre neto të shitjes të zbriten nga kostoja e produktit kryesor.
22	Një njësi ekonomike mund të përdorë teknika të tilla si metoda e koston standarde, metoda e çmimeve me pakicë ose të çmimit të blerjes më të fundit për të matur koston e inventarëve nëse rezultati nga përdorimi i këtyre metodave përfaqëson me koston. Kostot standarde marrin parasysh nivelet normale të materialeve dhe furnizimeve, të punës, efektivitetit dhe përdorimit të kapaciteteve. Ato rishikohen rregullisht dhe, nëse është e nevojshme, rishikohen duke u nisur nga kushtet aktuale. Metoda e çmimeve të shitjes me pakicë e mat koston duke zvogëluar vlerën e shitjes së inventarit me përqindjen e duhur të marzhit bruto.
	Zhvlerësimi i inventarit
23	Inventaret duhet t'i nënshtrohen testit të zhvlerësimit në datën e raportimit.
24	Kërkesa për vlerësimin e inventarit me vlerën më të ulët mes koston dhe çmimit të vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur e detyron njesinë ekonomike që të regjistrojë në kontabilitet humbjet nga zhvlerësimi në momentin kur ky i fundit ndodh. Zvogëlimet për të arritur në-çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur mund të ndodhin në ato raste kur ka një rënie të çmimeve të shitjes ose kur shpenzimet e përfundimit apo shpenzimet direkte të shitjeve janë rritur. Ka dhe raste kur disa produkte dëmtohen përpara se të shiten ose kur disa të tjerë mund të mbahen në sasira të tilla që nuk mund të shiten brenda një periudhë kohe të arsyeshme. Në raste të tilla, kostoja e inventarit duhet të zvogëlohet për të arritur në çmimin e vlerësuar të shitjes pakësuar me kostot për t'u përfunduar dhe shitur.
25	Shuma e uljes së vlerës duhet të përcaktohet zë për zë. Në rastet kur një vlerësim i tillë nuk është praktik, zhvlerësimi duhet të matet për një grup zërash të ngjashëm ose që kanë lidhje me njëri-tjetrin. Zërat janë të ngjashëm ose kanë lidhje me njëri-tjetrin nëse ato i përkasin të njëjtës linjë prodhimi si dhe kanë funksione ose përdorime të njëjta. Zvogëlimi duhet të marrë parasysh kostot e vlerësuar për përfundimin dhe shitjen e produkteve, por nuk duhet të përfshijë fitimin që do të krijohet në fazat e mëvonshme të prodhimit.
26	Çmimet e tregut për materialet dhe furnizimet për përdorim në prodhim mund të zbresin nën koston e tyre. Njësia ekonomike duhet të vazhdojë t'i mbajë në kontabilitet këto materiale me kosto dhe të mos bëjë ndryshime për zhvlerësimin e tyre nëse ajo parashikon që këto produkte do shiten me çmime më të larta se kostoja e prodhimit.
27	Shuma e rikuperueshme duhet të përcaktohet duke pasur parasysh kushtet që ekzistojnë në datën e raportimit. Ngjarjet ekonomike të cilat ndodhin pas mbylljes së periudhës kontabël duhet të konsiderohen në atë masë sa ato konfirmojnë kushtet që ekzistojnë në ose para datës së raportimit. Ky proces kërkon që të merren parasysh dhe të gjykohen me kujdes të gjitha të dhënat e disponueshme në lidhje me ndryshimet në çmimet e shitjes ose në kosto në periudhën pas datës së raportimit si dhe nëse këto ndryshime janë një reflektim apo një vazhdim logjik i kushteve ekzistuese në ose para datës së raportimit.
28	Një zvogëlim i bërë në një periudhë kontabël të mëparshme duhet të rimerret në ato raste kur kushtet mbi bazën e të cilave është bërë zvogëlimi nuk ekzistojnë më.
	Çregjistrimi
29	Inventari çregjistrohet atëherë kur shitet. Njësia ekonomike duhet ta çregjistrojë inventarin edhe në ato raste kur ai nuk ka më vlerë ekonomike në të ardhmen, si për shembull inventari i vjetëruar.
30	Momenti kur inventari duhet të çregjistrohet nuk është gjithmonë i lehtë për t'u përcaktuar. Për shembull, kur një njësi ekonomike furnizon një agjent shitjesh sipas një marrëveshje dorëzimi ose një marrëveshje shitblerjeje, rreziqet dhe përfitimet e lidhura me pronësinë e këtyre mallrave mund t'i përkasin njësisë ekonomike dhe për rrjedhojë këto mallra duhet të vazhdojnë të njihen si aktive nga njësia ekonomike.
	PARAQITJA E INVENTARIT NË PASQYRAT FINANCIARE
31	Inventarët paraqiten në pasqyrën e pozicionit financiar duke përdorur zërat përkatës në formatin e pasqyrës së pozicionit

	financiar të dhënë në SKK 2 <i>Paraqitja e Pasqyrave Financiare</i> . Një ndarje e mëtejshme e zërave të pasqyrës së pozicionit financiar mund të jepet në shënimet shpjeguese.
32	Kostoja e inventarit pasqyrohet në formatin 1 të pasqyrës së prformancës (shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës) duke përdorur zërat e mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> (a) “Ndryshimet në inventarin e produkteve të gatshme dhe prodhimit në proces”. Rritja e gjendjes së inventarit do të tregohet si një pakësim i shpenzimeve (“shpenzime negative”) dhe pakësimi i gjendjes së inventareve do të tregohet si një rritje të shpenzimeve; (b) Si pjesë e llojeve të tjera të shpenzimeve të treguara në pasqyrën e performancës (shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas natyrës) për shembull: shpenzime konsumi dhe amortizimi, lënda e parë dhe materiale të konsumueshme, dhe shpenzime të personelit.
33	Në formatin 2 të pasqyrës së performancës (shpenzimet e shfrytëzimit të klasifikuara sipas funksionit), kostoja e inventarit të shitur ose e materialeve të përdorura në prodhim paraqitet në zërin “Kosto të shitjeve”. Kostot e inventarit të përdorur për qëllime shpërndarjeje dhe administrative regjistrohen në zërat përkatës të pasqyrës së të ardhurave dhe shpenzimeve veças nga “Kosto të shitjeve”

SHËNIMET SHPJEGUESE

34	Në informacionet plotësuese të pasqyrave financiare në lidhje me inventarët duhet të paraqitet informacioni i mëposhtëm: <ul style="list-style-type: none"> (a) politikat kontabël të përdorura si dhe formulat e përdorura për llogaritjen e kostos; (b) vlerën kontabël të të gjithë inventareve si dhe vlerën kontabël të tyre sipas klasifikimit të bërë nga njësia ekonomike; (c) vlerën e inventarëve të njohur si shpenzim gjatë periudhës kontabël; (d) shumën e ndonjë zhvlerësimi të inventarit ose rimarrje të zhvlerësimeve të mëparshme; (e) vlerën kontabël të inventarit të dhënë si garanci; (f) vlerën kontabël të inventarëve që janë në ruajtje të palëve të tjera; (g) informacion mbi inventarin , shumat dhe nëse është e mundur për llogaritjen e vlerës, që nuk janë të regjistruara në pasqyrën e pozicionit financiar të njësisë ekonomike por që janë në ruajtje të saj.
----	--

DATA E HYRJES NË ZBATIM

35	Ky standard i ndryshuar do të zbatohet në pasqyrat financiare që mbulojnë periudha kontabël që fillojnë më ose pas datës 1 janar 2015. Ky Standard duhet të zbatohet në mënyre prospektive.
----	---

KRAHASIMI ME STANDARDET NDËRKOMBËTARE TË RAPORTIMIT FINANCIAR PËR NJËSITE EKONOMIKE TË VOGLA DHE TË MESME (SNRF PER NVM)

36	Tabela më poshtë tregon se si korrespondojnë paragrafët e këtij Standardi me SNRF për NVM-të përkatëse. Paragrafët janë konsideruar si korresponduese nëse ato trajtojnë në përgjithësi të njëjtën çështje pavarësisht nga fakti që standardet e referuara mund të kenë ndryshime.
----	--

Paragrafët e SKK 4	Paragrafët e SNRF për NVM botuar në korrik 2009
Paragrafi 1	Asnjë
Paragrafi 2	Asnjë
Paragrafi 3	Asnjë
Paragrafi 4	SEK 13.2
Paragrafi 5	SEK 13.3
Paragrafi 6	SEK 13.1
Paragrafi 7	Asnjë
Paragrafi 8	Asnjë
Paragrafi 9	SEK 2
Paragrafi 10	SEK 13.5
Paragrafi 11	SEK 13.6
Paragrafi 12	SEK 13.7
Paragrafi 13	Asnjë
Paragrafi 14	SEK 13.7 dhe 13.18
Paragrafi 15	SEK 13.5
Paragrafi 16	SEK 13.13
Paragrafi 17	SEK 13.9
Paragrafi 18	SEK 13.13
Paragrafi 19	SEK 13.10
Paragrafi 20	SEK 13.10
Paragrafi 21	SEK 13.10
Paragrafi 22	SEK 13.16
Paragrafi 23	SEK 13.19
Paragrafi 24	SEK 13.4 dhe 13.19
Paragrafi 25	Asnjë
Paragrafi 26	Asnjë
Paragrafi 27	Asnjë

Paragrafi 28	SEK 13.19	
Paragrafi 29	SEK 13.20	
Paragrafi 30	Asnjë	
Paragrafi 31	Asnjë	
Paragrafi 32	Asnjë	
Paragrafi 33	Asnjë	
Paragrafi 34	SEK 13.22	
Paragrafi 35	Asnjë	